

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6171
E shtunë, 21 nëntor 2020
çmimi 0.40

Më 26 nëntor takohen delegacionet teknike Kosovë-Francë për çështjen e vizave



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BASHKIMI EVROPIAN DHE QEVERIA E KOSOVËS KANË NËNSHKRUAR NJË KONTRATË ME VLERË 26.5 MILIONË EURO

AKTUALE

OBSH-ja: REMDESIVIRI TË MOS PËRDORËT PËR TRAJTIMIN E PACIENTËVE ME COVID-19 F. 2

FAMILJET E KATEGORIVE TË UÇK-së NË MALISHEVË: JEMI KRENARE ME LUFTEN E UÇK-së F. 7

VELIU, BE-SË: SERBIA PO GRUMBULLON DHE TRANSPORTON MIGRANTËT DERI NË AFËRSI TË KOSOVËS F. 6

OSMANI: SERBIA KËRKON QË TË SHTYHET ZHVARROSJA NË RASHKË, DËSHIRON TA FSHEHË KRIMIN F. 7

EKONOMI

QEVERIA SYNON TA FUQIZOJË ZHVILLIMIN E NDËRMARRËSISË NË VEND F. 9

'VETËM AJRIN E MINIERËS TA THITHËSH, ËSHTË MJAFT' F. 8

KULTURË

BOTA E FËMIJËVE NË KOHË PANDEMIE F. 14



Prof. dr. Teuta VINCA-KAFEXHOLLI

SPORT

HAJRIZI: PRESIM REZULTATE POZITIVE NDAJ SLOVAKISË DHE ISLANDË F. 14

KRIZA ME COVID-19, BE-ja NDAN 26.5 MILIONË EURO PËR KOSOVËN

Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria e Kosovës kanë nënshkruar të premtën një kontratë me vlerë 26.5 milionë euro e cila do t'i ndihmojë Kosovës të adresojë pasojat e pandemisë Covid-19. Pjesa e parë prej 20.5 milionësh pritet që të realizohet përpara fundit të këtij viti. Kjo mbështetje e re e BE-së do t'i sigurojë buxhetit të Kosovës fonde shumë të nevojshme për zbutjen e ndikimit socio-ekonomik të krizës së Covid-19 ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës



EULEX-i: GJETJA E MBETJEVE MORTORE NË KIZHEVAK U BË FALË IMAZHEVE FOTOGRAFIKE NGA AJRI

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), ka dhënë sqarime lidhur me gjetjen e mbetjeve mortore, më 16 nëntor, në Kizhevak të Rashkës, për të cilat dyshohet se janë të shqiptarëve të Kosovës. Ekspertët e EULEX-it kanë kryer gërmime në Kizhevak që prej vitit 2015. Pas disa sezoneve të pasuksesshme të gërmimeve në



Kizhevak, këtë vit ndodhi një përparim falë shfrytëzimit të imazheve fotografike nga ajri

HUNGARIA KONFIRMON VAZHDIMIN E MBËSHTETJES PËR FSK-në



RENOVA
PUTZ
Macedoni Xhepçisht-Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
-NDËRTIM
-PROJEKTIM
-SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Orban: Është e mundur arritja e një marrëveshjeje për buxhetin e BE-së

BUDAPEST, 20 NËNTOR- Kryeministri hungarez, Viktor Orban, ka thënë se bisedimet e bllokuara për buxhetin e BE-së, mbase do të përfundojnë me një marrëveshje, pavarësisht vetos së Hungarisë dhe Polonisë. BE-ja dëshiron që ta bëjë financimin të varur nga respektimi i sundimit të ligjit nga ana e vendeve anëtare. "Shumë zgjidhje janë të mundshme, kjo është vetëm një çështje e vullnetit politik", i tha Orban, radios publike të premtën.

Miratimi i paketës afatgjate

buxhetore të BE-së prej 1.8 trilionë eurosh, ku përfshihet edhe një fond për rimëkëmbjeje nga pandemia, hasi në veton e Hungarisë dhe Polonisë, më 16 nëntor.

Të dyja këto vende janë kritikuar shpesh nga institucionet e BE-së për mungesë të respektimit të lirisë demokratike.

Vetoja ka të ngjarë të vonojë fondet e domosdoshme të BE-së, në një kohë kur blloku po lufton me një valë të dytë të të infektuarve nga koronavirusi.

Orban ka pohuar se zgjidhjet e pranueshme për të dy vendet



"do të ishin ato të arritura në bazë të aspekteve ligjore dhe jo të shumicës politike".

Ai nuk dha më shumë detaje.

Ekonomia e Hungarisë, e cila ka qenë kryesisht e varur nga fondet e BE, është në një recesion më të thellë se sa pritej për shkak të pandemisë. Si Hungaria, ashtu edhe Polonia, janë nën vëzhgimin e BE-së për minimin e pavarësisht së gjyqësorit, medias dhe organizatave joqeveritare dhe ata rrezikojnë të humbasin qasjen në dhjetëra miliarda euro.

Franca dëshiron mbikëqyrje ndërkombëtare të armëpushimit në Nagorno Karabak



PARIS, 20 NËNTOR- Franca dëshiron mbikëqyrje ndërkombëtare të armëpushimit midis Armenisë dhe Azerbajxhanit të arritur më 10 nëntor me ndërmjetësimin e Rusisë. Të dyja vendet kanë zhvilluar luftime gjashtë javore për rajonin e shkëputur të Nagorno Karabakut.

Në bazë të marrëveshjes, në rajon do të vendosen trupat ruse për të garantuar armëpushimin, por në disa zona do të ketë edhe një prani të trupave turke. Franca është e

shqetësuar se Rusia dhe Turqia mund të arrijnë një marrëveshje, për të përjashtuar fuqitë perëndimore nga bisedimet e ardhshme të paqes, tha presidentja franceze. Përpjekjet për të zgjidhur konfliktin nga Grupi i Minskut i OSBE-së, i bashkëkryesuar nga Rusia, Franca dhe Shtetet e Bashkuara nuk kanë sjell ndonjë rezultat që nga viti 1992 dhe tre armëpushime të mëparshme të nënshkruara që kur luftimet shpërthyen përsëri më 27 shtator dështuan të

sjellin rezultate. Grupi i Minskut nuk ishte i përfshirë në arritjen e marrëveshjes së armëpushimit më 10 nëntor. Një burim i agjencisë "Reuters" brenda presidencës franceze tha se Parisi po bën presion për "mbikëqyrje ndërkombëtare" të armëpushimit për të lejuar kthimin e refugjatëve, për të organizuar kthimin e luftëtarëve të huaj, veçanërisht nga Siria, dhe për të filluar bisedimet mbi statusin e Nagorno Karabakut.

OBSH-ja: Remdesiviri të mos përdoret për trajtimin e pacientëve me Covid-19

NJU JORK, 20 NËNTOR- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka këshilluar institucionet shëndetësore që të mos e përdorin ilaçin antiviral Remdesivir për të trajtuar pacientët me Covid-19, që janë të shtruar në spital. Një panel i OBSH-së tha se ilaçi nuk ka "ndonjë efekt të rëndësishëm" në mbijetesë ose në uljen e


kohës së shërimit. Grupi i Zhvillimit të Udhëzimeve të OBSH-së (GDG) ka njoftuar se nuk kishte "asnjë provë të bazuar në të dhënat aktuale në dispozicion që ky ilaç përmirëson gjendjen e pacientit".

Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe dhjetëra vende të tjera kanë dhënë miratim të përkohshëm për përdorimin e

ilaçit antiviral që e prodhon Gilead Sciences, pasi një hulumtim fillestar tregoi se mund të shkurtojë kohën e shërimit të disa pacientëve me koronavirus të shtruar në spital. Presidenti amerikan, Donald Trump, i cili doli pozitiv për koronavirusin në fillim të tetorit, u trajtua me Remdesivir si dhe ilaçe të tjera.



Gjermania pritët t'i ketë rreth 15 milionë vetura elektrike deri më 2030



BERLIN, 20 NËNTOR- Gjermania do të duhet që t'i ndërtojë rreth 440 mijë stacione për rimbushjen e veturave elektronike deri në vitin 2030. Këtë të dhënë e ka bërë publike një studim i porositur nga Ministria e Transportit në Gjermani, që u publikua të enjten.

Studimi gjeti se pas dhjetë vitesh në rrugët e

Gjermanisë do të qarkullojnë rreth 14.8 milionë vetura elektrike. Aktualisht, Gjermania ka vetëm 33 mijë stacione publike për rimbushje të veturave elektrike. Studimi parashikoi që dy të tretat e hapësirave private të parkimit deri në vitin 2030 do të kishin një pikë për rimbushjen e veturave por

ato do të siguronin vetëm 41 për qind të energjisë elektrike të nevojshme për automjetet. "Për më tepër, pikat publike të rimbushjes janë një domosdoshmëri", ka thënë studimi. Në qytete, ishte i nevojshëm një stacion publik i rimbushjes për 14 automjete, ndërsa, në fshat sipas studimit duhej vetëm një për 23 automjete.

EULEX-i: Gjetja e mbetjeve mortore në Kizhevak u bë falë imazheve fotografike nga ajri

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka dhënë sqarime lidhur me gjetjen e mbetjeve mortore më 16 nëntor, në Kizhevak të Rashkës, për të cilat dyshohet se janë të shqiptarëve të Kosovës. Ekspertët e EULEX-it kanë kryer gërmime në Kizhevak që prej vitit 2015. Pas disa sezoneve të pasuksesshme të gërmimeve në Kizhevak, këtë vit ndodhi një përparim falë shfrytëzimit të imazheve fotografike nga ajri



EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) përmes një komunikate për media ka dhënë sqarime lidhur me gjetjen e mbetjeve mortore, më 16 nëntor, në Kizhevak të Rashkës në Serbi, për të cilat dyshohet se janë të shqiptarëve të Kosovës.

Sipas EULEX-it, të hënën, më 16 nëntor 2020, ekspertët nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Instituti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe Komisionit Qeveritar të Serbisë për Personat e Zhdukur zbuluan mbetje mortore në Kizhevak, ku ndodhet një gurore e madhe në Serbi. Ekspertët e EULEX-it kanë

kryer gërmime në Kizhevak që prej vitit 2015. Pas disa sezoneve të pasuksesshme të gërmimeve në Kizhevak, këtë vit ndodhi një përparim falë shfrytëzimit të imazheve fotografike nga ajri. "Problemi ishte se këto janë lokacione guroresh të mëdha dhe se peizazhi ka pësuar ndryshime të vazhdueshme me kalimin e kohës për shkak se kjo gurore ka qenë në përdorim ende për një numër të viteve", ka thënë Javier Santana, arkeolog forenzik i EULEX-it.

Procesi i identifikimit të vendndodhjes së saktë të mbetjeve mortore ishte komplikuar edhe më shumë për shkak të faktit se në këtë minierë janë katër deri pesë galeri ku secila ka një lartësi prej përafërsisht 13 metrash. Pas kërkesës së EULEX-it për t'i marrë imazhet fotografike nga

ajri të vitit 1999, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ia siguroi imazhet fotografike nga ajri Komisionit Qeveritar të Kosovës për Personat e Zhdukur dhe Komisionit Qeveritar të Serbisë për Personat e Zhdukur në fund të vitit 2019. "Ne i pranuan imazhet fotografike nga ajri në fund të vitit 2019. Mes fundit të vitit 2019 dhe fillimit të vitit 2020, koordinatori i EULEX-it për zhvarrime Krassimir Nikolov dhe unë i kemi analizuar fotografitë. Në bazë

të analizave tona ne u kthyem në atë lokacion në muajin shkurt 2020 dhe e piketuam vendndodhjen e saktë të këtij lokacioni. Kjo është koha kur filloi puna gjatë këtij viti", ka deklaruar Santana.

Pas identifikimit të lokacionit, ekspertët nga EULEX-i, Instituti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe Komisionit Qeveritar të Serbisë për Personat e Zhdukur kanë kryer punën në terren në Kizhevak, e cila solli deri te zbulimi i mbetjeve mortore. "Puna në Kizhevak është larg nga të përfunduarit. Procesi është shumë i ndërlikuar dhe merr shumë kohë. Për të pasur mundësi të vazhdohet puna, duhet të ketë një urdhër gjykatë. Pas kësaj, hapi tjetër është që të vazhdohet me zhvarrimet dhe gjetjen e mbetjeve mortore. Pasi të gjenden mbetjet mortore duhet të bëhet autopsia dhe do të merren mostrat e eshtrave për testet e profilit të ADN-së. Në rastet ku të afërmit e ndonjë personi të zhdukur i kanë dhënë mostrat e gjakut dhe do të ketë raport për përputhje pozitive të ADN-së, procesi i identifikimit përfundon. Pastaj, familjet informohen për identifikimin dhe atyre u

dorëzohen mbetjet mortore të personit të zhdukur", ka deklaruar koordinatori i EULEX-it për zhvarrime, Krassimir Nikolov.

Zëvendës drejtoresha e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës, Tarja Formisto, ka thënë se zbulimi i mbetjeve mortore në Kizhevak është një zhvillim tejet pozitiv dhe shpërblim për përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ndriçimin e fatit të më shumë se 1 640 personave, të cilët janë ende të pagjetur në Kosovë. "Çështja e personave të zhdukur është çështje e të drejtave të njeriut. Ajo ka të bëjë me të drejtat e njeriut të afërmve për të kuptuar se çfarë u ka ndodhur më të dashurve të tyre", ka theksuar Formisto, e cila edhe një herë u ka bërë thirrje të afërmve të të gjithë personave të zhdukur që t'i japin mostrat e gjakut për ta lehtësuar procesin e identifikimit.

Nga fillimi i mandatit të EULEX-it deri më 19 nëntor 2020, EULEX-i i ka kryer 662 operacione në terren për gjetjen e personave të zhdukur, përfshirë 169 zhvarrime. Janë identifikuar mbetjet mortore të 457 personave, përfshirë edhe ato të 317 personave të zhdukur.



Osmani: Serbia kërkon që të shtyhet zhvarrosja në Rashkë, dëshiron ta fshehtë krimin

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit, njëherësh edhe kryetare e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Serbia kërkon që të shtyhet zhvarrosja e trupave në Kizhevak të Rashkës sepse dëshiron të vazhdojë ta fshehtë

krimin. Në llogarinë e vet në "Facebook", ajo ka shtuar se fshehtë e fakteve është krim në vete andaj, sipas saj, çfarëdo vonese në këtë plan është krim i dyfishtë. "Gjetja e mbetjeve mortore në një lokacion në Rashkë të Serbisë, disa ditë më parë, rikthen vëmendjen te

1643 personat e pagjetur, për të cilët ende familjet presin në ankth dhe për të cilat nuk ka informacion as shteti i Kosovës. Serbia kërkon që të shtyhet zhvarrosja e tyre sepse dëshiron të vazhdojë ta fshehtë krimin. Fshehtë e fakteve është krim në vete, ndaj çfarëdo

vonese në këtë plan është krim i dyfishtë. Veprimet gjenocidale të Serbisë në Kosovë ende nuk kanë marrë përgjigje. Pranimi i fajit, kërkimfalja dhe vendosja e drejtësisë janë tri parakushtet për stabilitet, fqinjësi të mirë dhe paqe të qëndrueshme!", ka shkruar Osmani.





BASHKIMI EVROPIAN DHE QEVERIA E KOSOVËS KANË NËNSHKRUAR NJË KONTRATË ME VLERË 26.5 MILIONË EURO

BE-ja NDAN 26.5 MILIONË EURO PËR KOSOVËN

Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria e Kosovës kanë nënshkruar të premtën një kontratë me vlerë 26.5 milionë euro e cila do t'i ndihmojë Kosovës t'i adresojë pasojat e pandemisë Covid-19. Pajesa e parë prej 20.5 milionësh pritet që të realizohet përpara fundit të këtij viti. Kjo mbështetje e re e BE-së do t'i sigurojë buxhetit të Kosovës fonde shumë të nevojshme për zbutjen e ndikimit socio-ekonomik të krizës së Covid-19 ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës

eurosh të paguar në tetor dhe ndihmës emergjente për sistemin e kujdesit shëndetësor të dhënë më parë këtë vit. Ndërkaq mbështetje më e madhe pritet të vijë në muajt e ardhshëm.

Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësues i Posaçëm i BE-së, Tomas Szunyog, shprehu kënaqësinë për mundësinë që Kosova të ndihmohet sërish me ndihmë konkrete nga BE-ja. "Kosova dhe pjesa tjetër e Evropës janë në mes të pandemisë Covid-19. Më vjen mirë që përmes kësaj mbështetjeje BE-ja do të jetë në gjendje t'u ndihmojë bizneseve dhe grave dhe burrave të cenueshëm për t'i përballuar vështirësitë financiare me të cilat përballen në këtë situatë të vështirë", ka deklaruar Szunyog.

Me këtë rast, kryeministri Hoti ka falënderuar qytetarët dhe taksapaguesit e BE-së për

mbështetjen e deritanishëm e sidomos gjatë këtij viti derisa po përballemi me problemet ekonomike dhe sociale si rezultat i pandemisë Covid-19. "Jemi të lumtur që ekipet tona kanë punuar së bashku gjatë kësaj kohe për të siguruar që Kosova t'i përmbushë disa kërkesa specifike për ta marrë këtë mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore, e cila është më se e nevojshme në fund të vitit për t'i ndihmuar grupet specifike të qytetarëve tanë, përfshirë bizneset dhe për ta mbushur buxhetin e pakësuar për shkak të situatës momentale me pandeminë Covid-19", ka thënë Hoti.

Para ceremonisë së nënshkrimit të kësaj kontrate, kryeministri Hoti, bashkë me zëvendëskryeministrin Tahiri dhe Selmanaj, zhvilluan takim virtual me ambasadorin e BE-së, Tomas Szunyog. Në takim u bisedua për përmbushjen e

20.5 milionësh pritet të bëhet para fundit të këtij viti. "Kjo mbështetje e re e BE-së do t'i sigurojë buxhetit të Kosovës fonde shumë të nevojshme për zbutjen e ndikimit socio-ekonomik të krizës së Covid-19 ndaj qytetarëve dhe bizneseve të Kosovës", thuhet në një komunikatë të Zyrës së BE-së. Kontrata u nënshkrua nga udhëheqësi i Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësues i Posaçëm

i BE-së, Tomas Szunyog, dhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, pas një takimi në të cilin qeveria u zotua të hartojë kriteret e qarta dhe masa të targetuara mirë për përdorimin e fondeve. Kjo mbështetje e BE-së vjen pas një pajese për mbështetjen e buxhetit prej 10 milionë eurosh të bërë në muajin korrik, kredisë për ndihmë makro-financiare prej 50 milionë

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria e Kosovës nënshkruan të premtën një kontratë me vlerë 26.5 milionë euro e cila do t'i ndihmojë Kosovës t'i adresojë pasojat e pandemisë Covid-19. Sipas Zyrës së BE-së në Prishtinë, pajesa e parë prej

Edhe 11 të vdekur dhe 855 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) janë testuar gjithsej 1 930 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 855 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të të vdekurve nga Covidi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prishtinë tri raste (73, 72, 64 vjeç),

Prizren dy raste (88, 82 vjeç), Drenas një rast (70 vjeç), Ferizaj një rast (70 vjeç), Gjakovë një rast (71 vjeç), Gjilan një rast (79 vjeç), Kamenicë një rast (92 vjeç), Mitrovicë një rast (82 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 32 877 raste nga 127 722 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 885 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 748 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 19,772 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12,220. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 298

raste, Mitrovicë 62 raste, Gjilan 60 raste, Vushtrri 50 raste, Fushë-Kosovë 45 raste, Ferizaj 44 raste, Podujevë 37 raste, Prizren 36 raste, Lipjan 34 raste, Gjakovë 25 raste, Pejë 18 raste, Suharekë 17 raste, Drenas 15 raste, Viti 15 raste, Skenderaj 12 raste, Malishevë 11 raste, Kamenicë 10 raste, Klinë 10 raste, Shtime 10 raste, Deçan 8 raste, Rahovec 8 raste, Istog 7 raste, Obiliq 7 raste, Kaçanik 4 raste, Dragash 3 raste, Mamushë 3 raste, Klokot 2 raste, Novobërdë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Graçanicë dhe Zveçan.



European Union
in Kosovo

HUNGARIA KONFIRMON VAZHDIMIN E MBËSHTETJES PËR FSK-në

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka pritur të premten ambasadorin e Republikës së Hungarisë në vendin tonë, Jozsef Bencze, në vizitën e tij të parë në Ministrinë e Mbrojtjes. Në fillim ambasadori Bencze vlerësoi lart rëndësinë e partneritetit në mes dy ministrive duke shprehur gatishmërinë e shtetit hungarez dhe të institucioneve të saj për mbështetjen e mëtejme të FSK-së për arritjen e objektivave të saj. Ministri Quni falënderoi për vizitën dhe shprehu

mirënjohjen për mbështetjen e deritashme të Hungarisë në të gjitha fushat, përmes kontributit me kontingjentin ushtarak në kuadër të KFOR-it, për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Gjithashtu, ai ka kërkuar ofrimin e përvijës për procesin reformues të FSK-së si dhe përvijën e zbatuar të institucioneve hungareze për procesin integruar euroatlantik në NATO.

Ministri Quni në vazhdim ka theksuar se Ministria e

Mbrojtjes dhe FSK-ja janë në proces të realizimit të Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit, proces i cili zhvillohet në transparencë të plotë dhe, si gjithmonë, në koordinim të plotë me partnerët tanë.

Në fund të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë.

Në takim përkatës, ministri Quni shoqërohej nga këshilltari i tij politik, Feriz Trezhnjeva, kurse ambasadori Bencze shoqërohej nga sekretari i dytë

i ambasadës hungareze, Zoltan Gulyas.

Marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës (ish-Ministrisë së FSK-së) dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë është nënshkruar më 10 qershor 2016 në Budapest.

Marrëveshja përcakton bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe stërvitjes, shkëmbimit të përvijave në menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e krizave, rrugën e integritimeve euroatlantike etj.

kushteve të pajtuara ndërmjet Kosovës dhe BE-së për sa i përket përkrahjes së BE-së nga fondet IPA në buxhetin e vendit.

Gjatë takimit kryeministri Hoti ka prezantuar zbatimin e masave të mbështetjes ekonomike për t'i lehtësuar pasojat e pandemisë. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës do ta rrisë kontrollin e shpenzimeve dhe sigurinë e TI-së, si dhe do të bëjë hapa konkretë për t'i adresuar gjetjet e raportit të auditimit të IT-së të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës për vitin 2020.

Kryeministri Hoti dhe ambasadori Szunyog theksuan rëndësinë e procedurave transparente të prokurimit publik për ta fituar besimin e publikut. Ata u pajtuan t'i ndajnë arsyetimet për përdorimin e procedurave të negociuara për 18 muajt e fundit dhe ta zhvillojnë legjislacionin e ri për prokurim publik duke ndjekur praktikën më të mira legjislative.

Në takim u arrit pajtueshmëria që qeveria ta zbatojë me kujdes Ligjin për organizimin e administratës shtetërore kur harton strukturat e reja të brendshme të ministrive dhe ta mbikëqyrë kornizën e re ligjore për rekrutimet në këtë administratë, duke synuar depolitizimin e saj.



Veliu, BE-së: Serbia po grumbullon dhe transporton migrantët deri në afërsi të Kosovës

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 NËNTOR- Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu i është drejtuar përmes një letre publike, shefit të zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë/përfaqësues special i BE-së, ambasadorit, Tomas Szunyog.

Në fillim të kësaj letre, ministri Veliu vë në dukje se viteve të fundit, Republika e Kosovës dhe shtetet tjera të Evropës Juglindore, janë ballafaquar me një numër të shtuar të migrantëve të parregullt, të cilët në të shumtën e rasteve Kosovën e përdorin si një vend tranzit, për të arritur deri tek vendet e BE-së. "Jemi të vetëdijshëm se numri i migrantëve të parregullt ka shënuar një rritje të dukshme. Kjo rritje ka qenë sfidë për shtetin tonë, megjithatë, institucionet e Republikës së Kosovës kanë ngritur të gjitha kapacitetet e nevojshme për menaxhimin sa më të mirë të ndonjë fluksi të mundshëm me migrantë.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura, Qeveria e Republikës së Kosovës ka trajtuar dhe vazhdon t'i trajtoj në mënyrën më njerëzore, si dhe t'u ofroi migrantëve të gjitha kushtet e nevojshme, në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi", thuhet



më tej në letrën e ministrit Veliu. Ministri Veliu vë theksin se përgjatë viteve të fundit, janë duke hasur në raste kur autoritetet serbe në mënyrë të organizuar grumbullojnë dhe më pas i transportojnë migrantët deri në afërsi të kufirit me Republikën e Kosovës, me qëllim që të njëjtët të kalojnë përmes rrugëve ilegale në territorin e Republikës së Kosovës.

Ministri Veliu thekson se gjatë

intervistave të autoriteteve të Kosovës të zhvilluara ditëve të fundit me migrantë, janë njoftuar nga ata vetë që një numër prej rreth 400 migrantëve tanimë janë grumbulluar në afërsi të Preshevës, me qëllim që të transportohen deri në afërsi të kufirit me Republikën e Kosovës. "Për më tepër, të njëjtët kanë deklaruar së ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike dhe, përveç kësaj, janë

kërcënuar me dhunë në rast se do të tentojnë të kthehen përsëri në territorin e Serbisë. Për veprimet e tilla të autoriteteve serbe, është raportuar edhe në mediet e ndryshme ndërkombëtare", thekson shqetësimin e tij përmes kësaj letre ministri Veliu.

Në fund të kësaj letre publike, ministri Agim Veliu shprehë shqetësimin e tij dhe të Qeverisë së Republikës së

Kosovës lidhur me këto veprime të shtetit serb, të cilat janë në kundërshtim me Konventat Ndërkombëtare të cilat garantojnë të drejtat e njeriut dhe të trajtimit të migrantëve. "Një shtet që aspiron që në të ardhmen e afërt të jetë anëtare e familjes së BE-së, nuk do të duhej të ndërmerre veprime të tilla dhe të njëjtat nuk guxojnë asesi të tolerohen", ka përmbyllur letrën e tij ministri Veliu.

Kryeministri: Qeveria është e përkushtuar për respektimin e të drejtave të fëmijëve



PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER)- Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti mori pjesë të premten në konferencën për lansimin e rezultateve të Anketës Globale të Treguesve të Shumëfishtë 2020. Anketën ai e cilësoi si ndihmë konkrete që meriton vlerësim, ngaqë krijon pasqyrë të detajuar jo vetëm për fëmijët, por për mbarë shoqërinë tonë. "Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që me tërë potencialin e vet të punojë për t'u siguruar fëmijëve tanë, pa dallim etnie, ngjyre e besimi, të gjitha mundësitë që t'i jetojnë dhe t'i

shijojnë të drejtat që u takojnë dhe u garantohen edhe me legjislacionin në fuqi", ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka theksuar se, ne si komb, kemi arsye të veçantë të krenohemi me nobelisten tonë të paqes, Nënë Terezë, pasi që ajo, në Kalkutën e largët punoi me vullnet dhe sakrificë të jashtëzakonshme për fëmijët dhe njerëzit e tjerë të braktisur të atij vendi. "Sipas shëmbëllimit të saj, le të punojmë të gjithë për të ardhmen e fëmijëve tanë dhe të mbarë botës", ka thënë kryeministri Hoti.

Gjykimi ndaj Haki Rugovës caktohet për vitin e ardhshëm

ISTOG, 20 NËNTOR- Gjykata Themelore në Pejë e ka caktuar seancën gjyqësore ndaj kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, për

rastin ku ai akuzohet për konflikt të interesit, lidhur me një tender në vlerë prej rreth 300 mijë euro, të cilin sipas prokurorisë, e ka fituar

kompania që udhëhiqet nga vëllai i tij, Gani Rugova. Lajmin për "Betimi për Drejtësi" e ka konfirmuar kryetari i trupit gjykues, Sami Sharraxhiu. I

njëti bëri me dije se seanca ndaj të pandehurit Rugova është caktuar të mbahet më 22 janar 2021, duke filluar prej orës 10:00.



Familjet e kategorive të UÇK-së në Malishevë: Jemi krenare me luftën e UÇK-së

MALISHEVË, 20 NËNTOR (ER)-Komiteti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Martirëve të luftës së UÇK-së në Komunën e Malishevës, ka mbajtur të premtën mbledhje nën drejtimin e kryesueses, Vlora Manaj-Krasniqi.

Anëtarët e Komitetit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së pas kësaj mbledhje dolën me një reagim ndaj aktakuzave të ngritura nga Dhomat e Specializuara për ish-krerët e UÇK-së

“Komiteti për familjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, në Komunën e Malishevës, ka përcjellë me shqetësim zhvillimet e fundit në Kosovë, e sidomos zhvillimet pas ngritjes së aktakuzave ndaj krerëve të UÇK-së. Aktakuzat e ngritura nga kjo gjykatë dhe cilësimi i disa prej akterëve të UÇK-së, si ‘Ndërmarrje e përbashkët kriminale’, përveçse janë fyese e denigruese, mbi të gjitha këto aktakuza janë raciste dhe si të tilla të padrejta ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit shqiptar në përgjithësi”, thuhet në reagim.

Më tej në reagim theksohet se tendenca për ta njollësuar luftën çlirimtare dhe të drejtë të UÇK-së dhe përpjekjen e popullit shqiptar për liri është

padrejtësia e radhës që po i bëhet popullit shqiptar. “Është padrejtësi ndaj dëshmorëve të rënë dhe mijëra civilëve të vrarë e të masakruar, është padrejtësi ndaj mijëra grave të dhunuara dhe qindra e mijëra shqiptarëve tjerë të dëbuar nga atdheu i tyre. Prandaj i gjithë kombi shqiptar dhe e gjithë bota e civilizuar e demokratike e dinë fare mirë se ‘Ndërmarrje e organizuar kriminale’ ishte makineria ushtarake dhe policore e Serbisë, të cilët vranë, masakruan, dhunuan, terrorizuan dhe bënë gjenocid në Kosovë. Ne gjithashtu shprehim pakënaqësinë tonë edhe njëherë dhe nuk harrojmë se kjo padrejtësi e madhe ndaj shqiptarëve mjerisht ka marrë mbështetjen e një grupi të deputetëve shkurtpamës të cilët në vitin 2015 votuan në Kuvend këtë gjykatë speciale, pasojat e të cilës po i bartim tani si qytetarë të Republikës së Kosovës. Megjithatë jemi të bindur në pastërtinë e luftës së UÇK-së dhe jemi krenar me ekzistencën dhe historinë e saj, ndaj çdo përpjekje që ka për qëllim për ta njollësuar sakrificën e popullit shqiptar për liri, si e tillë është e padrejtë dhe e papranueshëm për mbarë kombin shqiptar”, përfundon reagimi i KFDIVM-së.



Më 26 nëntor takohen delegacionet teknike Kosovë-Francë për çështjen e vizave



PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Avdullah Hoti, ka bërë me dije se më 26 dhe 27 nëntor do të takohen delegacionet teknike të Kosovës dhe Francës për të diskutuar për çështjen e liberalizimit të vizave. “Më 26 dhe 27 nëntor 2020 do të mbahet takimi virtual i delegacioneve teknike nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe ajo e Republikës franceze, lidhur me bashkëpunim bilateral në fushën

e sigurisë dhe me fokus në çështje që lidhen me liberalizimin e vizave”, ka njoftuar Hoti. Aranzhimi i këtij takimi është rezultat i dakordimit ndërmjet kryeministrit të Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Republikës së Francës, Emmanuel Macron, gjatë videokonferencës të mbajtur të enjten. Pas takimit teknik shumë shpejtë pritet edhe takimi politik në nivel të ministrive të brendshme të të dyja vendeve

Kryetari i Prishtinës propozon mbylljen totale të vendit për një javë

PRISHTINË, 20 NËNTOR- Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka vlerësuar se Kosova ende nuk e ka kaluar valën e parë të Covid-19. “Po quhet vala e dytë, nuk mund të jetë valë e dytë pa përfunduar vala e parë. Nuk ka përfunduar vala e parë dhe tani kemi një përhapje dhe Prishtina prinë me numra. Atë që e kam thënë unë: Është matje e pasaktë!

Prishtina ka 12 mijë teste për dy javë që do të thotë se nuk po e krahasojmë më numrin e rasteve. I kam thënë Zemajt se njerëzit kanë menduar se po i kundërshtojë masat, por unë i kundërshtojë masat qesharake. Nuk është vetëm Prishtina keq por e gjithë Kosova”, ka thënë Ahmeti në “Rubikon” në Klan Kosova.

Ai ka sugjeruar se zgjidhja më e

mirë do të ishte mbyllja totale. “Të shkojmë në mbyllje totale për një javë në gjithë vendin, o të mos bëjmë humor me këto masa. Nuk ka kuptim që dikush i Kaçanikut të mos mund të vjen në Prishtinë në orën 7:00 e mund të shkojë në Shkup”, është shprehur Ahmeti. Sipas tij, Prishtina ka qenë respektuesi më i madh i masave nga fillimi i Covid-19.



Qeveria synon ta fuqizojë zhvillimin e ndërmarrësisë në vend



PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER)- Në vazhdim të aktiviteteve të Javës Globale të Ndërmarrësisë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë në bashkëpunim me Innovation Centre Kosova (ICK) organizuan një forum virtual rreth formësimit të politikave shtetërore për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrësisë në Kosovë, me zëvendëskryeministrin e Republikës së Kosovës, Besnik

Tahiri.

Duke folur për përfshirjen e ndërmarrësisë brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, zëvendëskryeministri Tahiri ka theksuar se brenda buxhetit të planifikuar për vitin e ardhshëm fokus i veçantë do t'i jepet nxitjes dhe fuqizimit të ndërmarrësisë përmes krijimit të lehtësirave për implementimin e ideve inovative. "Qeveria duke e pasur këtë bosht,

apo këtë shtyllë të rëndësishme të ekonomisë së vendit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit e ka një plan të caktuar, mirëpo në anën tjetër edhe me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike janë disa veprime të politikave që do të ndihmojnë, stimulojnë dhe subvencionojnë idetë inovative tek ndërmarrësia në Kosovë", ka thënë zëvendëskryeministri Tahiri.

Ndërsa, duke u ndërlidhur me ndryshimet e implementuara për t'u përshtatur me pandeminë Covid-19, zëvendëskryeministri foli mbi Ligjin për Nënshkrime Elektronike, i cili mundëson kryerjen e një game të madhe të shërbimeve pa prezencë fizike, të cilën ai e cilësoi si lehtësim për qytetarët, që rrjedhimisht mund të ndikojë në stimulimin e inovacionit, krijimin e vendeve të

punës dhe zhvillimin ekonomik. Tutje, Tahiri ndau me pjesëmarrësit se brenda qeverisë ekziston Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative që do të funksionoj në afat kohor për tetë vite, me qëllimin e intervenimit të menjëhershëm për zvogëlimin apo eliminimin e plotë të barrierave administrative që pengojnë zhvillimin e sektorit privat.

OAK-u ripërsërit kërkesën për heqjen e kufizimeve dhe përkrahje të bizneseve

PRISHTINË, 20 NËNTOR (ER)- Largimi i kufizimeve të lëvizjes dhe orarit të punës për bizneset, shtimi i masave disiplinore dhe respektimi i rregullave gjatë gjithë kohës, të gjinden mënyra për subvencionimin e kompanive të cilat shtojnë numrin e të punësuarve, përfshirja e rekomandimeve të bizneseve në ligjin për rimëkëmbje ekonomike, të lejohen 2 miliardë euro investime nga qeveria dhe barrierat me të cilat po përballen bizneset gjatë kalimit transit me mallra nëpër Serbi duke mos respektuar marrëveshjet, ishin disa nga çështjet që u ngritën në takim të përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me kryeministrin Avdullah Hoti

dhe këshilltarin Gazmend Qorraj.

Përfaqësuesit e OAK-ut në këtë takim kanë kërkuar edhe njëherë nga kryeministri heqjen e menjëhershme të orës policore dhe kufizimeve ose mbështetje direkte për bizneset dhe punëtorët për humbjet që po u shkakton ky vendim duke ua ndaluar të drejtën e punës, kërkesë kjo e dalë nga takimet që OAK-u po ka në vazhdimësi me bizneset dhe ankesat që po pranon në vazhdimësi nga bizneset.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e OAK-së theksuan që ndalesat që po bëhen nga ana e institucioneve po e dëmtojnë shumë biznesin edhe ashtu të rënduar si rezultat i pandemisë, duke shtuar që si rezultat i



mospërkrahjes financiare bizneset e kanë të pamundur që të mbajnë në punë numrin e të

punësuarve që kanë pasur deri më tani. Ndërsa sa i përket Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike,

nga OAK-u u kërkuar që të përfshihen edhe disa kërkesa të bizneseve.

'Vetëm ajrin e minierës ta thithësh, është mjaft'



PRISHTINË, 20 NËNTOR- Qazim Hyseni, 61 vjeç nga Mitrovica, që nga viti 1983 punon në minierën e Stantërgut në kombinatin metalurgjik "Trepça". Punën në minierë, ai e përshkruan si punën më të vështirë që mund ta bëjë dikush. "Miniera është minierë, vetëm ajrin e minierës ta thithësh është mjaft, edhe nëse asnjë punë tjetër nuk bën aty brenda", thotë ai.

Thellësia deri në horizontin e 12-të, sa ka miniera e Stantërgut, është deri në 800 metra nën sipërfaqen e tokës.

E puna, nën këtë sipërfaqe të tokës, thotë Qazimi, është shumë e rrezikshme. "Duhet pasur kujdes, përndryshe pëson. Një gabim e humb jetën", thotë ai. Në minierat e kombinatit metalurgjik "Trepça", nuk kanë munguar incidentet.

I fundit ka ndodhur në qershor të këtij viti, kur dy minatorë kanë vdekur si pasojë e shembjes së dheut në minierën e Artanës.

Ata vdiqën pasi që kishte ndodhur një shembje e papritur e masës shkëmbore në minierë.

Një incident të shembjes në

minierën e Stantërgut e tregon edhe Qazimi, i cili kishte shpëtuar siç thotë, ai "nga më e keqja". "Unë vetë kam pasur një rast. Kur kam shkuar të rregulloj një makinë ku ngarkohet xehja, edhe derisa e kemi rregulluar e kemi ngritur lart është shembur xehja dhe e ka zënë makinën, ka qenë një minutë që unë kam lëvizur nga vendi ku ka rënë xehja, përndryshe do të pësoja keq", tregon Qazimi. Kushtet në të cilat punohet në minierë, thotë Qazimi, janë të vështira, pasi që edhe vetë puna është e tillë. "Teknologjia është e vjetruar, por ka edhe makina të reja, makinat që unë i mirëmbaj, janë të vjetra diku 70 vjet, por janë në gjendje të mirë, e kushtet e punës janë ashtu siç i ka miniera, të vështira", thotë ai.

"Trepça" po shkatërrohet

"Trepça", e cila llogaritej si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në ish-Jugosllavi, që nga paslufta në Kosovë e vitit 1999, nuk ka arritur asnjëherë të vihet në funksion të

zhvillimit ekonomik të vendit. Qazimi thotë se kjo ndërmarrje po shkatërrohet nga mosmenaxhimi. "Për mua është e dhimbshme kur po e shoh 'Trepçën' kështu, në këtë gjendje të rëndë. Është e tmerrshme, çfarë po bëhet. Ka inxhinierë të ri, që çdo ditë rrinë këtu, nuk po punohet si duhet, nuk po udhëhiqet 'Trepça' si duhet, prandaj jemi në këtë situatë", thotë ai. "Trepça", sipas tij, me një menaxhim të duhur dhe me një ndihmë financiare nga Qeveria e Kosovës, do të mund të rifunksionalizohet.

Pagat herë pas here nuk jepen me kohë, minatorët hyjnë në greva

Qazimi, i cili ka një familje prej shtatë anëtarësh, thotë se paga që ai merr nga puna si mirëmbajtës i makinave në "Trepçë" është 700 euro, që gjatë viteve të fundit për shkak të problemeve financiare në këtë kompani, herë pas here nuk i është dhënë paga me kohë. "Tani nuk e kemi marrë ende pagën e tetorit. Është e vështirë se kemi

kredi. Me këto rroga jetojmë, nuk kemi të ardhura tjera", tregon ai për "Radion Evropa e Lirë".

Minatorët e kombinatit metalurgjik "Trepça", kanë hyrë të mërkurën në grevë brenda minierës, pasi që nuk kanë marrë pagat e tetorit.

Greva është ndërprerë, pasi që minatorët kanë marrë njoftimin se pagat do t'iu dalin në xhirologari. Pas kësaj situatë të krijuar, ushtruesi i detyrës së drejtorit të Bordit të ndërmarrjes "Trepça", Hysen Vrajolli, ka dhënë dorëheqje. Pas dorëheqjes së Vrajollit në këtë detyrë është emëruar Enes Muzaqi.

"Trepça" në borxhe

Ndërmarrja "Trepça" tani e sa kohë është duke kaluar në një krizë financiare.

Ish-ushtruesi i detyrës së drejtorit të Bordit të ndërmarrjes "Trepça", Hysen Vrajolli, pati deklaruar javë më parë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo ndërmarrje ka një borxh prej rreth pesë milionë eurosh ndaj Distribucionit të Furnizimit me Energji Elektrike

(KEDS) dhe operatorëve tjerë.

Qeveria e Kosovës më 13 nëntor ka ndarë mbi një milion euro për kombinatin metalurgjik "Trepça", si zgjidhje për t'i tejkaluar problemet financiare që ka aktualisht kjo kompani.

Aktualisht, "Trepça" merret me nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, kryesisht të plumbit dhe zinkut dhe është e vetmja prodhuese e këtij lloji në Kosovë. Por, prodhimi është shumë i ulët me vetëm rreth 150 mijë tonë xehe në vit, ndërsa në periudhën para vitit 1999, miniera prodhonte rreth 600 mijë tonë xehe në vit.

Edhe kapacitetet e saj humane janë zvogëluar, po ashtu, përgjatë viteve, duke u reduktuar në rreth 1,500 punëtorë nga më shumë se 20,000 sa ishin të punësuar në këtë kombinat dikur.

"Trepça" është shoqëri aksionare ku 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë aksione të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.

Kombinati metalurgjik "Trepça", gjendet në Mitrovicë. Sektorët e tij gjenden në pjesën veriore dhe atë jugore të qytetit.

Ndërtimi i urës në Dobërdol të Podujevës drejt finalizimit

Podujevë, 20 nëntor (ER)- Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i

shoqëruar nga drejtori i Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, ka vizituar fshatin

Dobërdol, ku janë duke u kryer punimet në ndërtimin e urës. Nën kryetari Rudari

uroi banorët e fshatit Dobërdol për realizimin e këtij projekti infrastrukturor.



406 nëna marrin nga 100 euro për foshnjat e tyre në Malishevë

MALISHEVË, 20 NËNTOR (ER)- Në kuadër të zbatimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për përkrahje financiare për nënat që lindin fëmijë, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka njoftuar se të premtën është bërë ekzekutimi i mjeteve për 406 nëna që kanë lindur fëmijë, kryesisht gjatë këtij viti, dhe kanë aplikuar për këtë përkrahje. “Janë ekzekutuar mjete për të gjitha ato nëna që kanë lindur fëmijë dhe kanë

aplikuar për përkrahjen që Komuna e Malishevës e ofron dhe bëhet për 406 nëna që kanë aplikuar, dhe të cilat përkrahen me nga 100 euro. Pra janë ekzekutuar 40 mijë e 600 euro”, ka bërë me dije drejtori Mazreku.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka sqaruar se kjo përkrahje bëhet sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, dhe përkrahja nga 100 euro për çdo fëmijë të lindur, ndërsa kjo përkrahje do

të vazhdojë për aq sa ky vendim është në fuqi dhe nuk ndryshohet me vendim tjetër. Ai gjithashtu ka bërë me dije se brenda vitit, është herë e dytë që ekzekutohen mjete për nënat që kanë aplikuar për përkrahje. “Në muajin prill është bërë ekzekutimi i mjeteve për 400 nëna dhe tani për 406 nëna, që i bie se brenda këtij viti janë përkrahur 806 nëna, apo shprehur në mjete, janë paguar 80 mijë e 600 euro”, ka thënë Mazreku.



Në Obiliq vendosen kamerat e sigurisë

OBILIQ, 20 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, së bashku me komandantin Sejdi Zeqiri në Stacionin Policor në Obiliq, kanë mirëpritur në takim ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i divizionit për siguri publike, Gazmend Hoxha dhe drejtori i drejtorisë rajonale, Fehmi Hoti, me ç'rast kanë diskutuar për situatën e përgjithshme të sigurisë në Komunën e Obiliqit. Në këtë takim, Gashi vlerësoi lart bashkëpunimin e jashtëzakonshëm institucional mes komunës dhe stacionit policor të Obiliqit.




Ai në këtë takim ka njoftuar për projektin e vendosjes së kamerave të sigurisë në qytetin e Obiliqit. Sipas tij, ky projekt

është investim komunal, ndërsa mbikëqyrja e tyre do të bëhet nga Stacioni Policor i Obiliqit.

Fillon asfaltimi i rrugëve në Shupkovc të Mitrovicës

MITROVICË, 20 NËNTOR (ER)- Në kuadër të projekteve në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë, ka filluar me asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Shupkovc të Mitrovicës. E për t'i parë për së afërmi punimet ka dalë edhe drejtori i kësaj drejtorie, Naser Muja, i cili ka potencuar se mbi 50 për qind e rrugëve në këtë fshat do të asfaltohen deri në fund të këtij viti, ndërsa pjesa e mbetur do të përfundojë në vitin e ardhshëm. Rregullimi i këtyre rrugëve do të kushtojë mbi 170 mijë euro, me gjatësi afro pesë kilometra dhe do të përfundojë tërësisht brenda vitit 2021.



Donatorë potencialë për ndërtimin e serave vizitojnë Kamenicën

KAMENICË, 20 NËNTOR (ER)- Nën kryetari i Komunës së Kamenicës, Faton Jakupi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Naim Arifi, dhe zyrtarë nga kjo drejtori, kanë pritur në takim një grup donatorësh potencial gjerman. Në këtë takim është diskutuar lidhur me investimet në ndërtimin e serave, fabrikës për përpunimin e produkteve bujqësore, po ashtu ndërtimin e teknologjisë së lartë të laboratorit, që ka mundësi të bëhen nga këta donatorë në Komunën e Kamenicës. Nën kryetari Jakupi ka thënë se komuna është e gatshme të bashkëpunojë me të gjithë investitorët të cilët janë të interesuar për investime. “Falënderojmë këtë ekipë profesionale për vizitën që e bënë në komunë. Ne jemi të

gatshëm që të bashkëpunojmë me të gjithë investitorët të cilët për qëllim kanë investimet në komunën tonë”, ka thënë ai. Ndërsa drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naim Arifi, ka thënë se takimet e tilla janë të mirëseardhura çdoherë. “Ne si drejtori angazhohemi që në vazhdimësi të jemi në shërbim të fermerëve që atyre t’iu sigurojmë përveç prodhimit edhe shitjen e produkteve tyre në tregjet e Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë angazhimi ynë do të vazhdojë që në komunën tonë të sjellim donatorë e investitorë të huaj, të cilët me investimet e tyre do të krijojnë vende të reja të punës”, ka thënë ai. Pas këtij takimi përfaqësuesit komunal së bashku me këta donatorë, kanë vizituar vendet potenciale për investime.



BOTA E FËMIJËVE NË KOHË PANDEMIE

(Sabile Keçmezi-Basha, “Në kohë pandemie nipat e mi s’ dalin prej shtëpie”,
Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë 2020, f. 86)



Prof. dr. Teuta
VINCA-KAFEXHOLLI

Për veprën “Në kohë pandemie nipat e mi s’ dalin jashtë shtëpie” nga Sabile Keçmezi-Basha, botim i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë, 2020. Nuk po ndalem te krijimtaria e deritashme e suksesshme e mikes sime Sabile Keçmezi-Basha, as te biografia e rrugës së saj jetësore, gjithashtu e pasur, por po ndalem te një kopsht kreativ që ma ka dërguar autorja.

Nuk më kujtohet cili nga shkrimtarët ka një lutje drejtuar lexuesve kur e përfundon hyrjen në veprën e tij e thotë: Urdhëroni e hyni pa trokitur në kopshtin tim poetik. Hyra dhe unë në kopshtin me lule e u takova me lulet e jetës së Sabile Keçmezi-Bashës që botërisht na i ofron autorja e veprës. Ata (ato) kanë gjallëri, kanë epitete, kanë shpirt dhe mbushin faqet e librit të ri. I gjen në çdo lagje këto lule të Prishtinës, që me gjuhë metaforike i mbushin vargjet. Ata janë tre vogëlushët Gerti, Darsi, Beni, ata flasin, gëzohen, pikëllohen, i kënaqin të afërmit e vet: gjyshen e gjyshin po na gëzojnë edhe neve të gjithë lexuesve e na thonë se e duam shkollën, i duam mësuesit, i duam shokët e shoqet, duam të mësojmë e të marrim sa më shumë informata të reja.. Na thonë neve të gjithëve: mos na shikoni veshjet stilistike, metaforat, poetikat së jashtmi e së brendshmi: nuk kemi lindur të ju lodhim me abstraksione në këto ditë pandemie botërore, po duam t’ju gëzojmë me disa çaste jete e të ju mbushim me optimizëm jete e t’ju themi se do ta përballojmë edhe këtë gjendje në Kosovën tonë kaq të vuajtur por jo të mposhtur. Pra më flasin mua dhe të gjithëve: ja ne jemi lulet që invenca krijuese e Sabile Keçmezi-Bashës na renditi në kopshtin poetik të saj. Urdhëroni pra e hyni pa trokitur në këtë kopsht me 50 poezi dhe me 81 faqe.

Që nga vjersha e parë, që është si hyrje e veprës “Në kohë pandemie nipat e mi s’ dalin prej shtëpie”, poetja ua bën me dije lexuesve për një kohë jo të zakonshme, pra për kohën e pandemisë globale që nuk la pa përfshirë edhe vendin tonë.

Bie në sy edhe aparaturore shkencore që poetja S.K. Basha e ka në disa poezi, për të plotësuar informacionet. Kjo na flet edhe për atë se penda e poetes dhe studiueses sonë, kanë qenë dhe janë të pandashme.


Ato që e begatojnë veprën në fjalë, janë edhe ilustrimet, vizatimet, fotografitë që e pasurojnë me kolorit tërheqës për botën e fëmijëve, të cilëve ua ngjall botën e kureshtjes edhe më shumë. Në disa vjersha kemi informacione për Wuhanin, prej nga është bartur virusi, pastaj për Stubllën e Vitisë, dr. Lul Rakën, për punën e tij të palodhshme në rrethana të vështira etj. Pra përveç anës artistike, vjershat e Sabile Keçmezi-Bashës luajnë rolin edukativ dhe njohës,


sepse na japin informacione, të cilat u përgjigjen kërkesave dhe psikologjisë së fëmijëve. Gjithashtu fëmijët marrin edhe këshilla të dobishme dhe të rëndësishme, të cilat nuk ndikojnë vetëm në shprehjet e mira jetësore, por edhe nxisin te ta dashurinë për artin letrar. Poetja jonë e ka të qartë se bota e fëmijëve mëson shumë përmes përjetimeve artistike.

Këtë recension dua ta mbyll me një mendim sinjifikativ të poetes të njohur dhe të dashur për

fëmijë Adelina Mamaqit: “Të shkruash për fëmijë, të hysh në zemrën e lexuesit, që ai të thotë se dua këtë libër, dua librin e këtij shkrimtari, është tepër e vështirë, sepse duhet të dish të futesh në psikologjinë e fëmijës”.

Pra vargjet e poetes Sabile, kanë një gjuhë të bukur letrare, me ngjyrimet poetike, me fjalor të pasur, të qartë, me informacione të shumta, duke e bërë veprën e saj mjaft tërheqëse, mbresëlënëse për lexuesit e vegjël.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Hajrizi: Presim rezultate pozitive ndaj Sllovakisë dhe Islandë

Drilon Hajrizi është optimist se Kosova do të marrë rezultate pozitive në dy ndeshjet e parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. "Ne do të japim maksimumin në këto dy sfida pa marrë parasysh se kush do të luaj. Nëse japim maksimumin, atëherë mund të kemi rezultate pozitive", ka deklaruar Hajrizi



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë të qëndrojnë në karantinë, para dy ndeshjeve me Sllovakinë dhe Islandën. "Dardanët" po stërviten në Marigona Residencë, derisa të hënën do të udhëtojnë drejt Bratisllavës për dy takimet në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Basketbollisti i Kosovës, Drilon Hajrizi ka folur për rrjedhën e përgatitjeve dhe dy ndeshjet e nëntorit. "Ne do të kemi edhe dy teste PCR para zhvillimit të ndeshjeve, ku do të mësohet cili do të

jetë ekipi i kompletuar për këto dy sfida. Me këtë fond të lojtarëve që jemi momentalisht, ne jemi duke u stërvitur maksimalisht dhe do të mundohemi të japim maksimumin. Sigurisht se nuk është e lehtë, pasi pandemia ka shkaktuar probleme, jo vetëm tek ne, por në mbarë botën, por besoj se me këso probleme po ballafaqohen edhe skuadrat kundërshtare, edhe pse nuk e kemi 12-shen e tyre", është shprehur Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së. Kapiteni i Pejës ka folur edhe për synimet në këto

ndeshje. "Ne do të japim maksimumin në këto dy sfida pa marrë parasysh se kush do të luaj. Nëse japim maksimumin, atëherë mund të kemi rezultate pozitive", ka deklaruar Hajrizi. Përballja e parë do të jetë ndaj Sllovakisë më 26 nëntor, kurse pas dy ditësh do të përballen me Islandën. Kosova nga dy ndeshje, ka shënuar dy fitore, duke mundur Islandën dhe Luksemburgun për të qenë lidere e grupit, kurse në muajin shkurt të vitit të ardhshëm do të përballen me Sllovakinë dhe Luksemburgun.

SHKURT

Strakosha shërohet nga Covidi

Lazio ka marrë lajme të mira edhe të premtën, pasi portieri Thomas Strakosha është shëruar nga Covid-19. Në këto kushte, sikurse protokollit e kërkon, Strakosha është paraqitur në klinikë për të bërë kontrollet mjekësore para se të nisë përgatitjet nën urdhrat e trajnerit Simone Inzaghi. Strakosha mungoi në Ligën e Kampionëve dhe në disa ndeshje në kampionat, për shkak se kishte dalë pozitiv me Covid-19. Situata e tij ka qenë e paqartë, pasi në klinika të ndryshme tamponët nxirrnin përgjigje të ndryshme.

Rrahmani rezulton pozitiv në testin për Covid

Kapiteni i Përfaqësues së Kosovës, Amir Rrahmani me t'u rikthyer te Napoli, është testuar për Covid-19. Skuadra e Napoli, ka lëshuar një komunikatë, duke bërë të ditur se Rrahmani ka dalë pozitiv në testimet e bëra. Tutje ceket se Rrahmani nuk ka pasur kontakte me futbollistët e tjerë, dhe është dërguar në izolim. Rrahmani ka qenë i grumbulluar te Kosova për ndeshjet e nëntorit. Në sfidën e fundit ndaj Moldavisë, ai u detyrua të largohet më herët nga loja, shkak i një lëndimi.

Boksieri i Kosovës fiton medaljen e bronzë

Boksieri i Kosovës, Remzo Mustafiq ka fituar medalje të bronzë në Evropianin për të rinj që po mbahet në Budvë të Malit të Zi. Mustafiq të premtën pasdite u paraqit në gjysmëfinale të kategorisë deri 91 kilogramë, ndërsa humbi nga ukrainasi Mykyta Gorbatenko. Mustafiq kishte vullnetin dhe dha goditje, por pati lëshime në mbrojtje që i kushtuan me humbje. Ai megjithatë ka fituar medalje të rëndësishme për boksion kosovar, që po kërkon më shumë suksese në skenën ndërkombëtare. Mustafiq, që është nga Mitrovica, fitoi në çerekfinale për të siguruar medaljen e vetme të Kosovës në këtë ngjarje për të rinj.

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Tri ndeshje të javës së trembëdhjetë në Superligën e Kosovës në futboll do të zhvillohen sot (e shtunë) nga ora 13:00. Gjilani që po lufton për kreun e tabelës e pret skuadrën e

Drenicës, derisa Besa e Pejës e pret kampionin në fuqi të elitës, Dritën e Gjilanit. Në Drenas, Feronikeli e pret skuadrën e Arbërisë. "Nikli" synon që të marrë tri pikë nga kjo përballje në

mënyrë që të ngritët në renditjen tabelore. Të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri", Prishtina e pret skuadrën e Trepçës '89, derisa derbi do të zhvillohet në Suharekë në mes Ballkanit dhe Llapit.

Ballkani është lider në Superligë, derisa Llapi edhe përkundër asaj se ka një skuadër me potencial renditet në pozitën e parafundit në tabelë. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 13:30.



Cabanas: Besa Famgas ka pritje të mëdha

PEJË, 20 NËNTOR - Kampionia e Kosovës, Besa Famgas, është e gatshme për dy ndeshjet e para evropiane të këtij edicioni. Të shtunën nga ora 16:00 dhe të dielën nga ora 15:00, Besa Famgas në palestrën "Karagaçi" në Pejë

luan ndaj skuadrës boshnjake, Bosna Vispak Visoko. Janë këto ndeshje të raundit të dytë të Kupës Evropiane. Besa Famgas po dominon në Superligë, ndërsa synimi është për hapa para në skenën evropiane. Pejanët

kanë formuar skuadër për të bërë lëvizjen para. "Nisim garimin evropian me mendje për të kaluar në raundin e tretë. Kemi pritje të mëdha", ka thënë trajneri spanjoll i Besa Famgas, Javier Cabanas. "Do të jetë vështirë pasi

Bosna Visoko është ekip i mirë. Por i luajmë dy ndeshjet në shtëpi dhe kjo duhet të jetë përparësi për ne. Nëse mbrohemi mirë dhe mund të vrapojmë në kundërsulm, besoj se mund të fitojmë", ka shtuar Cabanas.



Shala: Istogu është i gatshëm për dy ndeshje të mëdha

ISTOG, 20 NËNTOR - KHF Istogu po bën përgatitjet e fundit për ndeshjet e raundit të tretë të Kupës Evropiane ndaj skuadrës bjelloruse, Victoria-Berestie. Dy ndeshjet luhen në palestrën në Istog, sot (e shtunë) nga ora 18:30 dhe nesër (e diel) nga ora 18:00. Istogu në raundin e dytë të Kupës Evropiane e kishte eliminuar Vushtrinë. Tani ka punë me skuadrën shumë cilësore nga Bjellorusia, por trajneri Faruk Shala është optimist për paraqitje cilësore të Istogut. Ai ka thënë se skuadra e Istogut është e mobilizuar maksimalisht për këto dy ndeshje të rëndësishme. "Skuadra e Istogut është e mobilizuar maksimalisht për këto dy ndeshje të rëndësishme që përcaktojnë skuadrën që do të jetë pjesë e 1/8 së finales të Kupës Evropiane. Skuadra është në formë të mirë dhe e përgatitur fizikisht për këto ndeshje. Skuadra jonë është e gatshme për të dhënë maksimumin ndaj kundërshtarit shumë të fortë, që



vjen nga kampionati bjellorus, i njohur për cilësinë që ka", ka thënë Shala. Victoria-Berestie po dominon në kampionatin e Bjellorusisë këtë vit dhe ndoshta është kundërshtari më i fortë që kemi pasur përballë deri më tani. Por hendbollistët e mia kanë kualitetin e duhur që t'i zhvillojnë dy ndeshje të mëdha. Me pak fat, që shpresojmë të jetë me ne, kalojmë tutje. Fakti që dy

ndeshjet i luajmë në Istog na bën më të fortë dhe më të motivuar. Gjithë këto vite jemi angazhuar për të rrisim emrin e qytetit tonë. Tani që luajmë në qytetin tonë do të kemi edhe më shumë motiv e besim. Do të na mungojnë shikuesit në palestër, por do të bëjmë të pamundurën që të gjithë ata t'i bëjmë të ndihen mirë me angazhim dhe rezultat pozitiv", ka shtuar Shala.

Gjithçka gati për turneun 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Federata e Boksit e Kosovës ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e turneut ndërkombëtar në boks "Adem Jashari" që do të mbahet me 21-22 nëntor. Deri më tani konfirmimin e kanë bërë shtetet si Bullgaria, Zvicra, Sllovakia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shqipëria dhe Belgjika. Të enjten selektori i Belgjikës njoftoi se nuk do të marrin pjesë për shkak se tre boksierë të ekipit kanë dale pozitiv me Covid-19 dhe janë vetizoluar. Për shkak se palestra e sporteve në Prishtinë është e rezervuar për aktivitetet tjera ndërkombëtare, turneu "Adem Jashari" do të mbahet në palestrën e sporteve "Dilloni Benz" në Fushë Kosovë, ku i plotëson të gjitha kushtet e



kërkuara nga federata botërore AIBA, për mbajtjen e kësaj gare të madhe ndërkombëtare që është në kalendarin e garave botërore AIBA dhe kalendarin e garave evropiane EUBC. FboxK-ja do të respektojë këshillat e dala nga IKSHPK-ja, MKRS-ja, MSH-ja. që

në palestra të mbyllura mos të ketë më shumë se 50 persona (garues, trajnerë, delegatë, mjekë sportive. Turneu do të zhvillohet pa publik. Gjysmëfinalet do të organizohen me 21 nëntor nga ora 14:00. Finalet me 22 nëntor nga ora 12:00.

Mike Tyson rikthehet në ring pas 15 vitesh

Ish-kampioni i peshave të rënda Mike Tyson do të luftojë në një ndeshje në fund të këtij muaji. Tyson do të takohet me Roy Jones në një ndeshje jozyrtare me 8

raunde më 28 nëntor në Dignity Health Sports Park në Los Angeles. 54-vjeçari e përfundoi karrierën e tij me 50 fitore dhe gjashtë humbje. Nga 50 fitoret e tij, Tyson

fitoi 44 prej tyre me nokaut. Me fitoren e tij ndaj Trevor Berbick në vitin 1986, Tyson 20-vjeçar u bë kampioni më i ri botëror në peshat të rënda në histori. Tyson u

pezullua për një kohë të pacaktuar nga boksi pasi i kafshoi veshin Evander Holyfield në një ndeshje në qershor të vitit 1997. Tyson rifitoi licencën e tij pas një viti pas

një vendimi të gjykatës. Rekordi i 51-vjeçarit Jones aktualisht qëndron në 66 fitore dhe nëntë humbje ndërsa lufta e tij e fundit ishte dy vjet më parë.

SHKURT

Abgonlahori, Aston Villës: Transferojeni Rashicën

Ish-sulmuesi i Aston Villës, Gabriel Abgonlahori e ka këshilluar trajnerin Dean Smith ta transferojë një tjetër anësor në janar. Aston Villa vazhdon të lidhet me transferimin e Milot Rashicës, vlera e të cilit është 20.5 milionë funte. Transferimi i yllit të Kosovës në "Villa Park" nga Werder Bremen dështoi në verë, derisa 24-vjeçari mbeti në Bundesliga. Rashica raportohet se gjithashtu ishte pranë kalimit te Bayer Leverkuseni, por edhe ky transferim dështoi. Nga ana tjetër, ish-futbollisti i Aston Villës, Abgonlahori mendon se Aston Villa duhet ta transferojë Rashicën në afatin kalimtar dimëror. "Për Aston Villën, këshilloj ta bëjë hapin e ardhshëm dhe të sjellë futbollistë cilësor", ka deklaruar Abgonlahori kur u pyet nëse Aston Villa duhet ta transferojë Milot Rashicën.

Rivaldo: Ky është sezoni i fundit i Messit te Barcelona

"Messi po luan sezonin e fundit te Barcelona". Ky është mendimi i Rivaldos, një ish-futbollist i njohur i cili nuk ka as më të voglin dyshim kur është pyetur për të ardhmen e argjentinasi. "Nuk mendoj se do të arrijë drejtuesi i ri që të bëjë një hap prapa në vendimin e tij, duke parë që Barcelona nuk ka shumë resurse. Messi ka oferta të rëndësishme nga ekipe të tjera. Barcelona kërkon që të ulë pagat, pavarësisht faktit se Messi mund të largohet në fund të sezoni. Vetëm nëse fiton Ligën e Kampionëve dhe La Ligan, ose Koeman do të jetë në gjendje që ta bind me një ekip që luan mirë futboll. Vetëm kusht mendoj se Messi mund ta rishohë pozicionin e tij. Gjithsesi këmbëngul: Ky është sezoni i fundit i tij te Barcelona. Sigurisht, e them me trishtim", ka deklaruar Rivaldo.

Godin rezulton pozitiv me Covid-19


Diego Godin është futbollisti i radhës i testuar pozitiv me Covid-19. Mbrojtësi nga Uruguai është konfirmuar i infektuar me Covid-19, pas kthimit nga grumbullimi me kombëtare. "Cagliari njofton se kontrollet e fundit shëndetësore të kryera kanë nxjerrë në pah se Diego Godin është pozitiv me Covid-19", thuhet në njoftim e klubit italian. Tutje thuhet se futbollisti nuk ka pasur kontakte me futbollistët e tjerë të skuadrës dhe është izoluar menjëherë, ashtu siç kërkohet.

Xavi: De Jong do të shkruajë historinë me Barçën

Xavi Hernandez, legjenda e Barcelonës, beson se ish klubi i tij ka bërë shumë mirë me blerjen e Frenkie de Jong. Ai beson se De Jong do të lë gjurmë me fanellën e Barçës. "Jam gëzuar shumë kur Barcelona e bleu Frenkie de Jongun. I urova fat në 'Instagram', ai mu përgjigj duke thënë: 'Faleminderit, është nder'. E konsideroi atë një lojtar që mund të shkruajë një epokë me Barcelonën. Ai është lojtar i jashtëzakonshëm, nuk ka aspak frikë të kërkojë topin në zona shumë të vështira, është vërtet lojtar i mirë", ka thënë Xavi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

RREGULLORE PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Skenderaj, 2020

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja c) nenit 68 paragrafi 68.4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), dispozitave të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 Për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 Për Transparencë në Komuna, dhe sipas nenit 14 paragrafi 14.2 shkronja c) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008 Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur më datë _____ miraton:

RREGULLOREN PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E SKENDERAJT

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është rritja dhe forcimi i transparencës në punën e organeve të Komunës së Skenderajt, Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës: drejtorive të Komunës, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, ndërmarrjeve publike lokale dhe rritjes të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes.
2. Krijimi i rregullave që mundësojnë ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte elementare të çdo qytetari të Komunës së Skenderajt.
3. Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente publike.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasje në dokumente publike në dokumentet zyrtare të Komunës, me përjashtim të dokumenteve konfidenciale.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkresat e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim si më poshtë:

- 1.1. **Transparencë** - është veprimtaria e hapur e organeve të komunës që i siguron publikut dhe palëve të interesuara mundësin e pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës;
- 1.2. **Llogaridhënie** - e institucioneve për përgjegjësit e përcaktuara para qytetarëve për punën e kryer, vendimet e nxjerra si dhe veprimet që janë ndërmarr;

- 1.3. **Proces vendimmarrës** - përfshinë procesin e planifikimit, hartimit dhe të miratimit të politikave dhe legjislacionit sekondar nga komuna;
- 1.4. **Dokument publik** - nënkupton çdo akt, informatë në formë elektronike apo më zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik;
- 1.5. **Zyrtar përgjegjës** - nënkupton zyrtarin në të lartë administrativ, i cili është përgjegjës për vendimmarrje në kuadër të institucionit publik;
- 1.6. **Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike**- zyrtar administrativ i caktuar për pranimin, regjistrimin, shqyrtimin fillestar, ruajtjen, mbajtjen, dhe raportimin e kërkesave për qasje në dokumente publike;
- 1.7. **Kërkuesi i dokumentit** - çdo person fizik apo juridik pa diskriminim në çfarëdo lloj baze nën kushtet e përcaktuara me Ligjin për qasje në Dokumente Publike;
- 1.8. **Testi i dëmit dhe interesit publik** - test i ligjor që e vlerëson dëmin që do t'i shkaktohej interesit të mbrojtur kundrejt kundër interesit publik për publikim, që duhet të bëjnë institucionet publike para marrjes së vendimit për refuzim të publikimit të dokumenteve publike me vet iniciativë, si dhe para marrjes së vendimit për refuzimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, i cili duhet të përfshihet në arsyetim të vendimit mbi refuzim;
- 1.9. **Agjencia** - nënkupton agjencinë për informim dhe privatësi të themeluar në bazë të Ligjit të varant për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 1.10. **Komisioner/i/e** - organ i pavarur i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, në kuadër të Agjencisë, i cili është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të këtij Ligji dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 1.11. **Konsultimi publik** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes me qëllim të marrjes opinioneve, sugjerimeve, kërkesave dhe vërejtjeve të tyre, gjatë zhvillimit të procedurave të hartimit të politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve nënligjore të kuvendit të komunës;
- 1.12. **Palë e interesuar**- nënkupton çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjektet tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteteve të tij

1. Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe komiteteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjet që janë objekt diskutimi.
2. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komitetit përkatës siguron kushtet dhe mundësitë fizike për pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e parapara.
3. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose komiteti përkatës, nëpërmjet zyrës për marrëdhënie me publikun, njofton publikun së paku 7 (shtatë) ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose 3 (tri) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme, dhe brenda ditës për mbledhje urgjente, ndër të tjera përmes:

- 3.1. tabelës së shpalljeve të Komunës;
- 3.2. shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
- 3.3. mediave të shkuara dhe elektronike dhe;
- 3.4. ueb-faqes zyrtare të Komunës si dhe në rrjetet sociale.

4. Njoftimet publike sipas paragrafit 3, të këtij neni domosdoshmërisht duhet të përbajnë:

- 4.1. datën e mbajtjes së mbledhjes;
- 4.2. kohën e mbledhjes;
- 4.3. vendin e mbledhjes;
- 4.4. rendin e ditës me materialet e mbledhjes.

5. Kuvendi i komunës ose komitetet përkatëse me vendim shpallin mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Pushtetit Lokal 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta, 3 ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme të kuvendit të komunës dhe brenda ditës për mbledhje urgjente.

Neni 5 E drejta e peticionit

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë të parashtoj kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciativë qytetare dhe peticion, për çështje që janë përgjegjëse organet e komunës.
2. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi i komunës.
3. Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësit dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës.
4. Subjektet e përmendura më lart mund t'i drejtojnë peticionin kuvendit të komunës që janë në kompetencë të tij e që kanë të bëjnë me:

- 4.1. rregullimin e qytetit;
- 4.2. mirëmbajtjen e rendit dhe infrastrukturës së komunës- qytetit;
- 4.3. urbanizimin e qytetit dhe fshatit;
- 4.4. mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
- 4.5. zbatimin e vetëkontrollit; dhe
- 4.6. çështje tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

5. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga kuvendi i komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh sipas nenit 69 dhe 70 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
6. Pas diskutimit në kuvendin e komunës Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.

7. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nëshkures/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të cekët qartë në secilën faqe.

8. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është e cekur me lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.

9. Zyra për marrëdhënie me publikun, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ja prezanton Komitetit për Politike dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referoj për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar.

10. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, në rastin e shqyrtimit të peticionit.

11. Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend (sipas nenit 69 dhe 70 të LVL-së).

12. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i komunikohet parashtrues/it-ve të peticionit, jo me pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shqyrtimit të tij.

Neni 6 Takimet me publikun

1. Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarët së paku dy here në vit.

2. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

3. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.

4. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime, komente dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

5. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmuorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmuorin e dytë.

6. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve, ndertës/en-at e Komunës, dhe në vendet me të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë katërmëdhjetë (14) ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bënë zyra për marrëdhënie me publikun.

7. Tubimet publike i udhëheqë dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.

8. Kryetari është i autorizuar ta caktoj rendin e dilës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevojë ka të drejtë t'i ndërprejë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësit dhe kompetencat e Komunës. Ai mund t'i refuzoj, t'i thërras ose t'i dëgjoj diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktoj kohën e paraparë për diskutim.

9. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilin nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.

10. Për çdo tubim publik mbahet procesverbal, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

11. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit publik, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa.

12. Komiteti për politikë dhe Financa analizon çdo propozim të parashtruar në tubim publik dhe bënë rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 7 Konsultimi publik i akteve nënligjore të Komunës

1. Aktet nënligjore dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen konsultimit publik para se ato të miratohen nga Kuvendi i Komunës.

2. Afati i konsultimit publik zgjatë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike dhe jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së njoftimit publik.

3. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.

4. Zyra për marrëdhënie me publikun, njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për konsultim publik, përmes shpalljes publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës, mediave të shkruara elektronike dhe ueb faqe së komunës, etj.

5. Njoftimi publik, sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së konsultimit publik, vendin e mbajtjes së konsultimit publik dhe rendin e ditës të paraparë për atë konsultim publik.

6. Organi kompetent që ka propozuar aktin nënligjor duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqaroj përmbajtjen e aktit nënligjor para publikut.

7. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimit duhet të evidentohen dhe të shqyrtohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dhe jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike që nga dita e përfundimit të diskutimit.

8. Organi që ka propozuar aktin duhet të informoj Kuvendin për propozimet e dhëna në konsultimin publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysh.

9. Me rastin e miratimit të aktit nënligjor, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të aktit nënligjor.

Neni 8 Caktimi i zyrarit përgjegjës

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njëzia/zyrtari për komunikim me publikun.

Neni 9 Parimet e Konsultimit publik

1. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:

1.1. **Ligjshmërisë** – duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;

1.2. **Transparencës** – që nënkupton një qasje të hapur e Komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhë zyrtare;

1.3. **Barazisë dhe mos diskriminimit** – në mënyrë që të gjitha palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhë zyrtare;

1.4. **Efikasiteti në procesin e konsultimit publik** – duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar me lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt – propozimeve.

Neni 10 Dokumentet për konsultim publik

1. Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

1.1. Projekt-planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës/ekzekutivit;

1.2. Projekt-buxhetin e Komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor.

1.3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme;

1.4. Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimtimit në nivelin lokal, në kuadër të fushave sektoriale;

1.5. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivelin lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;

1.6. Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik;

1.7. Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

Neni 11 Format dhe teknikat e konsultimit publik

Format dhe teknikat e konsultimit publik, parashihen në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Neni 12 Planifikimi i konsultimeve publike

Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe në rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

Neni 13 Zbatimi i standardeve të konsultimit publik

1. Komuna siguron publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqen zyrtare të Komunës, dhe në platformën e konsultimeve publike në nivel qendror.

2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.

3. Komuna për politikën e caktuara të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të sigurojnë konsultimin në fazat e hershme të hartimit, dhe palët e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes.

4. Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jep sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

Neni 14 Aktet nënligjore të Komunës për konsultim publik

1. Aktet e Komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:

- 1.1. Draft-Statuti i Komunës;
- 1.2. Projekt-Rregulloret Komunale;
- 1.3. Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

Neni 15 Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik

Kryetari i Komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzimet administrative.

Neni 16 Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi

Komuna obligohet të koordinohet me MAPL-në dhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për konsultim publik.

Neni 17 Transparenca e vendimeve të organeve të Komunës

1. Publikimi në ueb-faqen zyrtare të Komunës të akteve nënligjore të Komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm.

2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve hyn në fuqi pas nënshkrimit dhe publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Neni 18 Transparenca financiare

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarr veprime konkrete në publikimin e tyre në ueb-faqen zyrtare të Komunës.
2. Planin e buxhetit pas miratimit në Kuvendin e Komunës, dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacionin sektorial.
4. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
5. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial.
6. Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Neni 19 Transparenca në aktivitetet e prokurimit

1. Komuna publikon në ueb – faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në ueb-faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

Neni 20 Qasja e drejtpërdrejtë në dokumente publike

1. Komuna siguron qasje në dokumente publike përmes ueb-faqes zyrtare të saj, si:

- 1.1. Planin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
- 1.2. Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara;
- 1.3. Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane;
- 1.4. Raportin vjetor të punës së Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
- 1.5. Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve obligative;
- 1.6. Të dhënat për biografite e udhëheqësve të lartë të organeve të Komunës;
- 1.7. Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e e-mail-it të drejtuesve të njësisve brenda institucionit;
- 1.8. Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licencën leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen; edhe
- 1.9. Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
- 1.10. Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigjeje për shërbimin e kërkuar.

Neni 21 Hartimi i planeve vjetore të punës në Komunë

1. Komunitat obligohen që të hartojnë planet vjetore të punës së Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.
2. Në harmoni me pikën 1 të nenit 22 të kësaj rregullore, komuna obligohet të hartoj planin për komunikim me publikun dhe planin për konsultim me publikun.

Neni 22 Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje

1. Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:

- 1.1. planifikimi;
- 1.2. diskutimi;
- 1.3. marrja e vendimit;
- 1.4. implementimi; dhe
- 1.5. monitorimi.

2. Mekanizmat e lartpërmendur duhet të shfrytëzohen me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje, si:

- 2.1. Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes të cilave qytetarët do të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre;
- 2.2. Përfshirjen e qytetarëve në grupet punuese;
- 2.3. Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje;
- 2.4. Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin;
- 2.5. Fuqizimi i bashkëpunimit mes Komunës dhe shoqërisë civile.

3. Duke promovuar qeverisje të mirë Komuna inkurajon personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, minoritetet, të rinjtë dhe gratë, për përfshirje në procesin e vendimarrjes, duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

Neni 23 Plani i veprimit për transparencë në Komunë

1. Komuna obligohet të hartoj planin 4 (katër) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në Kuvendin e Komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.
2. Plani i veprimit për transparencë në komunë, ka për synim t'i ofroj publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

3. Plani duhet të përfshijë:

- 3.1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
- 3.2. Mbledhjet e Komiteteve;
- 3.3. Takimet publike;

- 3.4. Takimet konsultative;
- 3.5. Takimet obligative me media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të Komunës;
- 3.6. Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të Komunës;
- 3.7. Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi;
- 3.8. Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët;
- 3.9. Procedurat transparente të prokurimit;
- 3.10. Procedurat transparente të punësimit;
- 3.11. Publikimin e aktiviteteve ditore në faqen zyrtare;
- 3.12. Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimarrje.

Neni 24 Gjuhët për komunikim zyrtarë

1. Pjestarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civil të komunës.
2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehin në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
3. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve, dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet duhet të jenë në gjuhën zyrtare siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
4. Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën zyrtare siç parashihen me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
